



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-048

Prishtinë, më 12 nëntor 2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 12 NËNTOR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Albulena Haxhiu, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi dhe Bilall Sherifi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Kërkesa e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, për mbajtje të seancës së jashtëzakonshme,
2. Shqyrtimi i kërkesave.

* * *

1. Kërkesa e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, për mbajtje të seancës së jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit se kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancë të jashtëzakonshme për shqyrtimin dhe miratimin e pakos së ligjeve për sundimin e ligjit dhe agjendën integruese evropiane, më 13 nëntor 2018.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar të kryeministrit, z. Haradinaj, diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli; Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit; Albulena Haxhiu, në emër Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të LVV-së; Bilall Sherifi, kryetar i GP të Nismës Socialdemokrate; Ahmet Isufi, kryetar i GP të AAK-së dhe Memli Krasniqi, kryetar i GP të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të martën, më 13 nëntor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i pakos së ligjeve për sundim të ligjit dhe agjendën integruese evropiane.

2. Shqyrtimi i kërkesave:

2. 1. Kërkesa e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal për lejimin e udhëtimit zyrtar në Maqedoni

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Kryetares dhe anëtares së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Sala Berisha-Shala dhe Duda Balje, u lejohet udhëtimi zyrtar në Shkup (Maqedoni), prej 26 - 28 nëntor 2018.

2. 2. Kërkesa për aprovimin e vizitës zyrtare të një delegacioni nga Senati Italian në Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet vizita e delegacionit gjashtë (6) anëtarësh nga Senati i Italisë, i cili do ta vizitojë Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga 15 - 17 nëntor 2018.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale